
17 VERIFIKIMI DHE PËRZGJEDHJA E MATERIALEVE BIBLIOTEKARE TË LARGUARA

Verifikimi i të dhënave për materialet mund të bëhet vetëm kur në skedarin e konfigurimit vendosen parametra të veçantë.

Kushti

Skedarët që përmbajnë listën e materialeve të ofruara për largim duhet të jenë skedarë të zakonshëm tekst, të ruajtur në kompjuterin tuaj.

Procedura

1. Tek klasa **COBIB.AL** përzgjidhni metodën **Klasa / Verifiko të dhënat për materialin**.

Hapet dritarja **Shtimi i shtojcave**, e cila mundëson qasje në të gjitha dosjet në kompjuterin tuaj. Tek "Përzgjidh dosjen" shfaqet emri i dosjes fillestare, përzgjidhni skedarin dhe klikoni butonin **Në rregull**.

Dosjen e përzgjidhni nëse nga lista përzgjidhni diskun e duhur, ndërsa në listën, në të cilën shfaqet tek disku i përzgjedhur, gjeni dosjen dhe skedarin përkatës.

2. Të dhënat bibliografike për materialet nga lista mund t'i krahasoni me të dhënat bibliografike në regjistrimet në bazën lokale dhe të përbashkët. Nëse të dhënat bibliografike nga regjistrimi në bazën lokale nuk përputhen me të dhënat bibliografike nga regjistrimi në bazën e përbashkët, hapet dritarja **Krahasimi i regjistrimeve**, ku ndryshimet janë të nënvizuara.

Nëse dëshironi që regjistrimet t'i printoni, klikoni butonin **Printo**. Dritaren e mbyllni nëse klikoni butonin **Mbyll**.

Hapet dritarja **Transferimi i të dhënave për materialin** me pyetjen, nëse dëshironi që të dhënat për materialin t'i ruani në skedarin me materialet e përzgjedhura dhe komentet e regjistruara në mënyrë automatike.

Nëse klikoni butonin **Po**, të dhënat për materialin ruhen, mirëpo nëse klikoni butonin **Jo**, vazhdon verifikimi i të dhënave për materialin duke respektuar kushtet e tjera.

Nëse klikoni butonin **Anulo** mund të ndërprisni verifikimin e të dhënave për materialin dhe pas ekzekutimit të sërishëm të metodës **Klasa / Verifiko**

të dhënat për materialin vazhdoni procedurën e verifikimit tek ky regjistrim.

3. Kur krahasimi i të dhënave bibliografike për materialin përfundon dhe të dhënat ruhen, ose nëse krahasimi i të dhënave nuk është ekzekutuar fare, hapet dritarja, ku mund të shënoni komentin, i cili do të paraqitet në titullin e raportit KB-PL-B13 (shih kap. *D.3.9*). Përgatitet edhe raporti KB-PL-B14, për të cilin gjithashtu mund të shënoni një koment të ri (shih kap. *D.3.10*).
4. Skedarët tekst me listën e materialeve të përzgjedhura ruhen në mënyrë automatike në të njëjtin vend në kompjuter, ku është e ruajtur edhe lista e pranuar nga biblioteka. Emri bazë i skedarit është i njëjtë me emrin e listës së pranuar.

Në skedarin me mbaresën *_reas.txt për çdo COBISS.AL-ID është përshkruar arsyeja e përzgjedhjes së një materiali.

Në skedarin me mbaresën *_out.txt për çdo COBISS.AL-ID ndodhen të dhënat për koleksionet e materialit të përzgjedhur në bibliotekën, e cila ka dërguar listën. Skedarin e redaktoni dhe e ktheni në bibliotekën, e cila do t'ua dërgoj materialin e përzgjedhur.